



Planuar / Dorezuar Punimjen / Prodator Received / Delivery	24.08.2022	2 viti god. year	
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot. Br. Pr. / Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIMSHICK	4945/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.621/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani- anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.621/2022 të datës 15.07.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.08.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.621/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar sipas Akt emërimit me numër 686 të datës 25.08.2014, në pozitën "Udhëheqës i sektorit të prokurimit" në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".

Me datën 07.03.2022, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini, ka parashtruar kërkesën me numër Nr.Prot.580 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses për tek Komisioni disiplinor në UIBM.

Me datën 06.04.2022, Komisioni Disiplinor për punëtorët e administratës-nëpunës të shërbimeve publike ne Universitetin "Isa Boletini" ne Mitrovicës, ka nxjerre Vendimin Nr.Prot.848, sipas te cilit ankuesen e ka gjetur përgjegjëse për shkelje të nenit 46 pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për

Zyrtarët Publikë dhe i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndalimi 20% të pagës për periudhën në katër (4) muaj”.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin Nr.Prot.848 të datës 06.04.2022, të Komisionit Disiplinor të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, me datën 19.04.2022 ka parashtruar ankesën me Nr.Prot.933 për tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në UIBM. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datën 11.05.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.1122, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses dhe ka lënë në fuqi vendimin me numër 848 të datës 06.04.2022 të Komisionit Disiplinor në UIBM.

E pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor dhe atij të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datën 15.07.2022 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4148/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 19.08.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 4148/2022 për përgjigje në ankesë tek Universiteti i Mitrovicës, ndërsa me datën 22.08.2022 përmes shkresës me numër protokollit 4856/2022, Universiteti i Mitrovicës ka kthyer përgjigjen në ankesën e ankueses me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4148/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e ankueses me numër Nr.Prot.933 të datës 19.04.2022 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër Nr.prot.1122 të datës 11.05.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër Nr.Prot.848 të datës 06.04.2022 nga Komisioni Disiplinor; Kërkesën e datës 02.03.2022 nga ankuesja; Faturën e datës 31.01.2022 me numër 0000192; Shkresën me Nr.Prot.242 të datës 31.01.2022 së bashku me faturën me numër 0000189 të datës 28.01.2022; Shkresën me Nr.Prot.224 të datës 28.01.2022 së bashku me faturën me numër 0000181 të datës 19.01.2022; Shkresën me Nr.Prot.131 të datës 19.01.2022 së bashku me faturën me numër 0000186 të datës 24.01.2022; Shkresën me Nr.Prot.163 të datës 24.01.2022; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 08.03.2022 lidhur me inicimin e procedurës disiplinore; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 08.03.2022; Ftesën për deklaram në takimin e radhës të komisionit disiplinor të datës 09.03.2022; Kërkesën me numër Nr.Prot.580 të datës 07.03.2022 lidhur me fillimin e procedurës disiplinore nga Sekretari i përgjithshëm në UIBM për ankuesen; Njoftimin e datës 04.03.2022 përmes e-mailit zyrtar; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022; Njoftimin me numër Nr.Prot.546 të datës 04.03.2022 lidhur me nxjerrjen e urdhrit për blerje nga zyra e prokurimit; Njoftimin e datës 09.03.2022 përmes e-mailit zyrtar; Njoftimin e datës 09.03.2022; Ftesën për deklaram në takimin e radhës të komisionit disiplinor të datës 09.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të ankueses me numër 686 të datës 25.08.2014 së bashku me përkrahimin e detyrave të punës të datës 23.04.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses** *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur si në dispozitiv të vendimit.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.621/2022, datë 24.08.2022

Ardita Ferçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses*
- *Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Mitrovicës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Mitrovicës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*